

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORE

NOTER ALKETA I. DESHALLA
ADRESA ISA BOLETINI, SULEJMAN
DELVINA, NR.1754, KATI I PARE
TEL: 696434886

MARRËVESHJE SIGURUESE

(MARRËVESHJE KOLATERALI FINANCIAR)

Nr. repertori: 1194


Nr. koleksioni: 382

Vlore më 02/07/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021062040042746844

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE VLORE

Nr. 1194 Rep. Nr. 382 Kol

MARREVESHJE E BARRES SIGURUESE

Ne Vlore, Shqiperi, me date 02 Korrik 2021 (dy mije e njetete e nje), perpara meje
Alketa Deshalla Notere ne Dhomen e Notereve Vlore, me zyre te regjistruar ne rrugen
"Saleman Delvina" Vlore Shqiperi, u paraqiten palet e meposhtme:

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA, me qender ne Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, hyrja 1, Njesia bashkiake 10, Kodi Postar 1001, Tirane, Shqiperi, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane, Shqiperi sipas Vendimit Nr. 20830, date 12 Shkurt 1999 dhe me Kod Fiskal Nr. 3708057, dhe NIPT J91725007P e perfaqesuar ligjerisht nga **Griselda Osmenaj**, i identifikuar nga leternjoftimi i saj shqiptar me Nr. 028468191 dhe Nr. Personal G65502245M, ne cilesine Drejtuese Dege dhe **Blerina Veshaj**, identifikuar nga pasaporta e saj shqiptare Nr. BA7080956 dhe Nr. personal H85827079G, ne Konsulente shitjesh per Bizneset, me poshte quajtur "**Banka**".

REGINA GROUP SHPK, me qender ne VLORE Rruga Murat Terbaçi, Lagjja Uji Ftohtë, Kulla Nr.2, Kati 1-5-6-7-8(9 nen), Shqipëri, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT L06719202G, perfaqesuar ligjerisht nga: Vasil Laver Bedinaj mbajtës i Pasaportes Shqiptare nr. BG3586414, Nr. Personal H20707075Q leshuar me 05.04.2011 nga Ministria e Brendshme, ne cilesine e perfaqesuesit, sipas Vendimit nr. 04, dt. 01.07.2011 te Asamblesë; qe ketu e meposhte do te quhet "**Barredhenesi**".

Vasil Laver Bedinaj, i datelindjes 07.07.1972, shtetas shqiptar, banues ne Rruga Rradhime-Vlore, Shqipëri, mbajtës i Pasaportes Shqiptare nr. BG3586414, Nr. Personal H20707075Q leshuar me 05.04.2011 nga Ministria e Brendshme, qe ketu e meposhte do te quhet "**Barredhenesi**".

Sonila Tomorr Bedinaj e datelindjes 15.05.1983, shtetase shqiptare, banuese ne Rruga Rradhime-Vlore, Shqipëri, mbajtëse e Leternjoftim ID nr. 033091248, Nr. Personal I35515058D leshuar me 27.04.2016 nga Ministria e Puneve te Brendshme; me poshte quajtur do te quhet "**Barredhenesi**".

Pasi verifikova statusin ligjor te palëve dhe te perfaqesuesve te tyre unë, Noteri, arrita ne përfundimin se ato janë madhorë, me zotësi te plotë juridike për te vepruar si dhe ne përputhje me kërkesat e ligjit. Palet me vullnetin e tyre te lire e te plote bien dakord qe te lidhin kete marreveshje Barre Siguruese me kushtet dhe afatet si me poshte vjon:

Percaktime:

Ne kete marreveshje, pervec kur diktohet ndryshe nga permbajtja, (1) kjo Marreveshje perfshin ndryshimet apo dokumentat aksesore te kesaj Marreveshje, apo çdo Dokument te Kredise; (2) nenet, seksionet, dhe anekset i referohen neneve, seksioneve dhe anekseve te kesaj Marreveshje; Ne kete marreveshje kur ne permbajtjen e njerit prej Neneve apo Paragrafeve te saj eshte vendosur shenja "xxxx" atehere ai Nen apo Paragraf do te jete i pa aplikueshem dhe nuk do te merret parasysh gjate intepretimit te kesaj marreveshje pa cenuar vlefshmerine e Neneve ose Paragrafeve te tjere, Ne kete marreveshje, pervec kur eshte perc ktuar ndryshe:

a. fjalet qe jane ne njejes perfshijne edhe shumetin dhe anasjelltas;

- b. kredimarres perfshin edhe barredhenes;
c. kredimarres perfshin edhe bashkekredimarres, nese ka te tille;

I. QELLIMI DHE OBJEKTI I MARREVESHJES

1. Kjo Marreveshje sherben si mjet sigurimi per te garantuar Banken per shlyerjen e kredise dhe te gjitha detyrimeve te parashikuara ne Kontraten e Kredise te lidhura midis Bankes dhe Kredimarresit REGINA GROUP SHPK si me poshte:

- a) Kontrata e Kredise Nr.Rep.1105, Nr.Kol 450 date 06.03.2021, noter Mirjam Isufaj, e lidhur midis Bankes dhe Kredimarresit REGINA GROUP SHPK ne shumen 50,000,000 (pesedhete milion leke);
- b) Kontraten e Kredise Nr. Rep. 8692, Nr.Kol 2665 date 26.11.2020, noter Ridvana Ruci, e lidhur midis Bankes dhe Kredimarresit REGINA GROUP SHPK ne shumen 1,650,000 (nje milion e gjashteqind e pesedhete mije) ,
- c) Kontraten e kredise Nr. 1336 Rep dhe Nr. 637 Kol date 16/04/2020 lidhur midis Bankes dhe Kredimarresit REGINA GROUP SHPK ne shumen EURO 270,000;
- d) Kontraten e Kredise Nr. 1860 Rep dhe Nr. 901 Kol date 09/06/2020 lidhur midis Bankes dhe Kredimarresit REGINA GROUP SHPK ne Shumen EURO 50,000

nga a) tek d) ketu e ne vijim Kontrate Kredie)


2. Sipas afateve dhe kushteve të kesaj Marreveshje dhe ne perputhje me Ligjin nr. 8537, dt. 18/10/1999 "Per barret siguruese" i ndryshuar, Barredhenesi vendos barre siguruese te rradhes se pare ne favor te Bankes mbi kolateralin e pershkruar me poshte:

- Barre Siguruese ne favor te Bankes mbi 100% kuotave te Kapitalit te Shoqerise REGINA GROUP SHPK, me NUIS L06719202G, qe Barredhenesi Vasil Bedinaj zoteron ne cilesine e ortakut te shoqerise REGINA GROUP SHPK. Barra siguruese shtrihet automatikisht mbi të gjitha kuotat e ardhshme dhe të drejtat e lidhura me to që barredhenesit mund të zotëroj(n)ë tek Shoqëria në çdo kohë, përfshirë pa kufizim, të gjitha Kuotat e nënshkruara nga Barredhenesit si rezultat i rritjes, së të kapitalit, në zbatim të kushteve dhe afateve të Kontratës së Kredise.
- Barrë siguruese ne favor te Bankes mbi te gjitha pasuritë/asetet e shoqërisë kredimarrese REGINA GROUP SHPK referuar bilancit te shoqerise, duke perfshire asetet e tashme dhe te ardhme te shoqërisë REGINA GROUP SHPK;

Barra siguruese do te regjistrohet ne Regjistrin e Barreve Siguruese dhe Banka do te kete kopjen origjinale te vertetimit përkatës dhe ne Qendren Kombetare te Biznesit.

II. DETYRIMET E BARREDHENESIT

3. Ne çdo kohe qe Banka konstaton se vlera e kolateralit eshte zvogeluar ose eshte duke u zvogeluar, si dhe kur Banka çmon se vlera e tij nuk mjafton per te mbuluar detyrimin, Barredhenesi, me kerkesen e Bankes, detyrohet te jape garanci shtese per te arritur mbulimin e plote te shumes se siguruar nga kolaterali.



4. Barredhenesi nuk do te krijoje ose pranoje venien e ndonje barre tjeter mbi kolateralin pervec gjithashtu, se kolaterali i barresuar nuk eshte nen ekzekutim te detyrueshem ose ndaj tyre nuk jane vendosur detyrime ose barre, pervec barres ne favor te kesaj Banke.
5. Barredhenesi nuk ka te drejte te transferoje, te tjetersoje kolateralin e barresuar apo te zvogeloje vleren e tij pa miratimin paraprak me shkrim te Bankes.
6. Barredhenesi bie dakord qe kolaterali i dhene ne favor te bankes do te mbahet i bllokuar ne llogarine e tij deri ne shlyerjen e plote te detyrimit te kredise dhe Barremarresi nuk mund te kryeje veprime me kete kolateral.
7. Gjate kohezgjatjes se kesaj Marreveshje dhe Kontratave te Kredive te permendura me siper, Barredhenesi eshte i detyruar te mirembaje kolataralin me shpenzimet e tij.
8. Barredhenesi do te njoftoje menjehere Banken per cdo fakt dhe rrethane qe mund te rrezikojë ekzekutimin e Barres Siguruese.
9. Barredhenesi do te njoftoje menjehere Banken, me kerkesen e kesaj te fundit, per gjendjen e kolateralit.
10. Pervec nga sa parashikohet me siper, Barredhenesi nuk do te krijoje ndonje hipoteke, peng ose barre siguruese mbi mjetet e tij, pa marre me pare miratimin me shkrim nga Banka.
11. Kolaterali mund te ndryshohet vetem me marreveshje me shkrim te nenshkruar nga te gjitha palet ne kete Marreveshje.
12. Ne rastet kur Banka nis ekzekutimin e nje pjese apo teresise se Kolateralit te pershkruar me siper, do te aplikohen dispozitat perkatese te parashikuara ne kuadrin ligjor/rregullativ te aplikueshem ne fuqi.

III. EKZEKUTIMI I BARRES SIGURUESE

13. Ne rastet kur kolaterali eshte llogari, instrument, ose titull, dhe Kredimarresi/Barredhenesi nuk permbush detyrimet e tij per shlyerjen e Kredise (principalin, interesat etj,) ose kur ndonje prej Kredive maturohet apo behet menjehere e pagueshme, siç percaktohet ne Kontraten e Kredise:
 - a. Banka rezervon te drejten te njoftojë Barredhenesin qe t'i paguajë Bankes shumën e llogarisë, te instrumentit ose titullit, dhe pasi te ketë zbritur shpenzimet e arsyeshme të bëra për arkëtimin, t'i përdorë paratë e arkëtuara për përmbushjen e detyrimit të siguruar nëpërmjet barrës siguruese.
 - b. Barredhenesi autorizon Banken qe ne menyre te parevokueshme dhe pa njoftim paraprak:
 - i. te debitoje (arketoje) llogarine e kolateralit ne cdo kohe dhe per cdo detyrim ne vonese sipas Kontrates se Kredise;
 - ii. te debitoje (arketoje) llogarine e kolateralit per ripagimin e vleres totale te Kredise se bashku me interesat dhe kamate vonesat e llogaritura deri ne ate dite sipas kushteve

te Kontrates Kredise, ne rast se Kredimarresi/Barredhenesi eshte ne vonese per me shume se 60 (gjashtedhete) dite.

14. Ne rastet kur kolaterali eshte nje send i luajtshem, dhe Kredimarresi/Barredhenesi nuk permbush detyrimet e tij per shlyerjen e Kredise (principalin, interesat etj,) ose kur ndonje prej Kredive maturohet apo behet menjehere e pagueshme, siç percaktohet ne Kontraten e Kredise, Banka rezervon te drejten:

- i) të njoftojë Barredhenesin që t'i dorezoje kolateralin dhe ta perdore ate për përmbushjen e detyrimit të siguruar nëpërmjet barrës siguroese. Barredhenesi menjehere pas marrjes se njoftimit nga Banka, do te dorezoje kolateralin me shpenzimet dhe ne pergjegjesine e tij ne çdo vend te percaktuar nga Banka, bashke me dokumentet perkatese.
- ii) ne rast se Barredhenesi nuk e permbush detyrimin per te dorezuar kolateralin sipas njoftimit te Bankes, Banka ka te drejte te marre ne posedim kolateralin dhe dokumentet perkatese nepermjet procedurave te ekzekutimit te detyrueshem.

IV. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

15. Kjo Marreveshje mbetet ne fuqi deri sa kredimarresi i siperpermendur te shlyeje plotesisht ne favor te Bankes kredite qe ka marre nga Banka, se bashku me interesat perkatese dhe te gjitha shumatat e tjera te pagueshme sipas Kontratave te kredive ekzistuese si dhe ndryshimeve te ketyre kontratave qe do te lidhen ne te ardhmen ndermjet Bankes dhe kredimarresit te siperpermendur, sic percaktohet ne nenin I.1 te kesaj Marreveshje.
16. Ne rast se Kredimarresi i siperpermendur nuk permbush detyrimet e tij ose nuk ka paraqitur te dhena te sakta, te cilat Banka i ka marre si baze per te dhene kredine, ose kur ndodh njeri nga rastet e mospermbushjes, siç percaktohen ne Kontraten perkatese te kredise, Banka ka te drejte te zgjidhe Kontraten perkatese te kredise ne menyre te njeanshme dhe te procedoje me mbledhjen e detyrimit.
17. Kjo marreveshje rregullohet dhe zbatohet ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar dhe palet ketu pranojne t'i nenshtrohen Juridiksionit te Gjykatave Shqiptare.
18. Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Marreveshje, Barredhenesi deklaron se i gjithë informacioni që ka dhënë është i saktë dhe i plotë dhe se do të informojë Bankën për çdo ndryshim në të ardhmen. Barredhenesi konfirmon se ka marrë, ka lexuar, ka kuptuar dhe eshte dakord me termat dhe kushtet e kësaj Marreveshje.
19. Barredhenesi deklaron se: Në kuptim të parashikimeve të Ligjit nr.9887, dt.10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, jap pëlqimin tim paraprak, që të dhënat e mia personale dhe cdo informacion tjetër qe kam dhene ne lidhje me kete sherbim, Banka ka te drejte, ne perputhje me legjislacionin e aplikueshem në Republikën e Shqipërisë, ta perpunoje, ta transmetoje tek persona te lidhur me Banken, dhe/ose grupit të kompanive të specializuara në administrimin dhe / ose përpunimin e të dhënave personale dhe sensitive të Bankës dhe / ose klientëve të Bankës brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si edhe nga palët e treta (duke përfshirë por jo duke u kufizuar në banka korrespondente, operatorët ndërmjetësues që kryejnë shërbime të tilla etj.) si dhe pranë subjekteve partnere/ kontraktore.



Pranoj që në numrin tim personal të celularit/ postën elektronike (e-mail)/ adresën postare të deklaruarë prej meje pranë Bankës me këtë Marreveshje ose më pas nese do te kete ndryshime, te njoftohem nga Banka sipas rastit, për çështje që kanë lidhje me marrëdhëniet e mia si Klient me Bankën.

20. Në zbatim të detyrimeve ligjore, Banka ka marrë të gjitha masat për aplikimin e teknologjive dhe procedurave specifike për ruajtjen e të dhënave personale të klientit. Gjithashtu Banka kërkon nga çdo palë kontraktore e cila përpunon apo ka akses në të dhënat për efekt të operimit të transaksioneve bankare, respektimin e rregullave të sigurisë dhe konfidencialitetit, të cilat janë gjithashtu elemente të vlerësimit gjatë negociatave parakontraktore, si dhe sanksionohen në Marreveshjen që Banka nënshkruan me partnerët e saj të biznesit

21. Kjo Marreveshje është titull ekzekutiv.

Kjo Marreveshje është pjese perberese dhe e pandare e Kontratave te kredise te permenduara ne paragrafin I te kesaj kontrate.

Kjo Marreveshje është hartuar ne kater (4) kopje identike në gjuhen shqipe.

Unë noterja pasi ua lexova palëve me zë të lartë përmbajtjen e kësaj Marreveshje, konstatova se ajo vjen në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, dhe pasi ata nënshkruan në praninë time, unë noterja vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

PALET NENSHKRUESE

BANKA
BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE sha
Përfaqësuar nga:

BARREDHENESI
REGINA GROUP SHPK
Përfaqësuar nga:
Vasil BEDINAJ

Griselda Osmenaj

Blerina Veshaj

Griselda Osmenaj

Blerina Veshaj

Vasil Bedinaj

Sonila Bedinaj

NOTER Alketa Dëshalla

Alketa Dëshalla

Vasil Bedinaj

Sonila Bedinaj



Vlore, më 01/04/2021

VENDIM Nr. 041

ASAMBLEJË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË "REGINA GROUP" SH.P.K

Solli në Vlorë, më 01.04.2021, u mbledh rregullisht në selinë e shoqërisë, dhe në përputhje me procedurat e para shikuar në Ligjin 9901, Datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare" Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë HOTEL REGINA-GRUP SHPK, Shoqëri e cila është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me qendër në VLORE Rruga Murat Tërbaçi, Lagjja Uji Ftohtë, Kulla Nr.2, Kati 1-5-6-7-8(9 nen), Shqipëri, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar me NIPT L06719202G,

U pranishëm në mbledhje ishte ortaku i shoqërisë i cili përfaqëson 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë:

1. Z. Vasil Laver Bedinaj, i datëlindjes 07.07.1972, shtetas shqiptar, mbajtës i Pasaportes Shqiptare nr. BG3586414, Nr. Personal H20707075Q leshuar me 05.04.2011 nga Ministria e Brendshme

U diskutuan dhe u miratuan ceshtjet e mëposhtme të rendit të ditës:

- a. Miratimin për Sigurimin e kredisë me kolateralin/garancite Barre Siguruese në favor të Bankes mbi mbi 100% kuotave të Kapitalit të Shoqërisë "REGINA GROUP SHPK, me NUIS L06719202G, që Barredhësi Vasil Bedinaj zoteron në cilësinë e ortakut të shoqërisë REGINA GROUP SHPK. Barra siguruese shtrihet automatikisht mbi të gjitha kuotat e ardhshme dhe të drejtat e lidhura me to që barredhësit mund të zotëroj(n)ë tek Shoqëria në çdo kohë, përfshirë pa kufizim, të gjitha Kuotat e nënshkruara nga Barredhësit si rezultat i rritjes, së të kapitalit, në zbatim të kushteve dhe afateve të Kontratës së Kredise.
- b. Emërimin e përfaqësuesit të shoqërisë Z.Vasil Bedinaj për të nënshkruar Kontraten e kredise, kontraten e hipotekes, marrëveshjen siguruese, kontraten e kolateralit financiar dhe cdo kontrate apo dokument me Banka Amerikane e Investimeve SH.A, në përmbushje të pikave të mësipërme të Rendit të Ditës.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
HOTEL REGINA-GRUP SHPK

Vasil Bedinaj

VASIL BEDINAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L06719202G	
2. Data e Regjistrimit	19/05/2010	
3. Emri i Subjektit	REGINA GROUP	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	18/05/2010	
6. Kohëzgjatja	Nga: 18/05/2010	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Vlore Vlore VLORE Rruga Murat Tërbaçi, Lagjja Uji Ftohtë, Kulla Nr.2, Kati 1-5-6-7-8(9 nen)	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Hoteleri dhe veprimtari ndihmese lidhur me kete aktivitet. Ndertimi I jahteve apo mjeteve te tjera lundruese. Te transportoje turiste dhe persona ne keto mjete. Te marre ne perdorim, te tregtoje, te leshoje me qira te gjitha llojet e mjeteve lundruese detare qofshin ato motorrike apo jo.Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez. Qiradhenie e pasurise se luajtshme dhe te paluajtshme. Rezervime online hoteleri. Operator turistik detar	
10. Administratori/ët	Klarita Belloj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 24/01/2020	Deri: 23/01/2025
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	VasilBedinaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	100,00	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>	
12.4 Komete (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	<p>Vlore Vlore VLORE Lagjja Pavaresia, Zona Kadastrale 8602, Ndertese 5-kate, me nr.pasurie 28/80-ND, vol.87 fq235</p> <p>Vlore Orikum RADHIME Bar-Plazhi, Zona Kadastrale Nr.3140, Nr.Pasurisë 139/25</p> <p>Vlore Vlore VLORE Regina Gift Shop Vlore, Rruga Murat Tërbaçi, Lagjja Ui i Ftohte, Kulla Nr.2, Kati I.</p> <p>Vlore Orikum RADHIME Anije turistike REGINA BLU model VAMO PERKINS D3900M Nr.B-387.</p> <p>Vlore Vlore VLORE Mercedes Benz nr shasie WDB9026711R552761, Targa AC378T (Transport per punetoret per nevoja te kompanise)</p> <p>Vlore Vlore VLORE Mjet i vogel Lundrues SOLEMAR 1 Motor, Nr.matrikullës 643-480087, Gjatesia 5.18m, Gjeresi 2.2m</p> <p>Vlore Vlore VLORE Anija " Hapy Regina ", Porti Detar Vlorë</p> <p>Vlore Vlore VLORE Mjet i vogel Lundrues "EMMAL",Model 50GXI Dp,2 Motara, Nr.matrikullës 4012131815/4012131823.</p> <p>Vlore Vlore VLORE Vlore, Mjet Lundrimi me emrin " REGINA GRUP-ENEA", Viti PRODHIMIT 2018, Gjatesi 22 m, Gjeresi 6.99 m, Zhytje 1.09 m, Fuqia motorike 328 KW</p> <p>Vlore Vlore VLORE Ish Uzine Mekanike Sode, Rruga Sazani, Zona Kadastrale nr.8604, Pasuria 40/17, Volumi 11, faqe 118 (Kantier Anijesh)</p> <p>Vlore Orikum RADHIME Fshati Radhime, Kompleksi regina, Vendi Kanul, Godine 1</p>
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	<p>Emri Tregtar: REGINA GROUP E-Mail: financa@hotelregina.al Telefon: 0692065399</p>
15. Statusi:	Aktiv



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Datë: 25/06/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2021/06/25 09:50:06 +02:00
L067192Q2G2021062509494804
2006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)